



Planuar / Dorezuar Punimja/Prodato Received/Delivery	28.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Ni Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
DOMSHCK	5718/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.715/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 715/2022 të datës 19.08.2022 të parashtruar nga ankuesja

me adresë banimi në kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 28.09.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.715/2022 e datës 19.08.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja tani e pensionuar, me datë 19.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4815/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës lidhur me njohjen e së drejtës së kompensimit të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit duke u bazuar në Kontratën Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunën e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 06.09.2022 ka dërguar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4815/2022 të datës 19.08.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dëshminë me numër Lënda: 2020:003184 lidhur me dorëzimin e padis në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Ekstraktin e lindjes me numër E23934880 të datës 04.09.2019; Vendimin me numër 14-070/01-302359/2019 të datës 20.12.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën emër numër të protokollit 14-070/01-302359/2019 datës 12.12.2019 të parashtruar nga ankuesja në Komunën e Prishtinës; Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Administratës sektori i bashkësisë lokale (me datë të pa dukshëm); Vërtetimin me Nr.05/2992/19 të datës 01.08.2019 i departamentit të pensioneve; Vendimin me numër 14-118/02-116513/19 të datës 21.05.2019 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 05.09.2019; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4948/2022 të datës 24.08.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5165/2022 të datës 06.09.2022; Akt emërimit me 01.nr.112-842 të datës 01.02.2017; Vendimin me numër A.nr.239/19-01 të datës 09.12.2019 i zyrës rajonale për ndihme juridike falas; Procesverbalin e datës 20.12.2019 me rastin e shqyrtimit të ankesës së datës 28.09.2022 nga së bashku me dëshminë për pranimit të Vendimit nr.14-070/01-302359/19 të datës 20.12.2019 .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa A.nr.715/2022 e datës 19.08.2022, është parashtruar e *jashtë afatit ligjore, SEPSE:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Akt-i të Emërimit 01 Nr.112-842 të datës 01.02.2017 ka qenë e punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën " *Zyrtare për Shërbim me Qytetarë*". Me Vendimin 14-118/02-116513/19 të datës 21.05.2019 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ankueses i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 29.06.2019, duke i njohur kompensimin e një page mujore të njëhershme me vlerën e pagës së fundit gjegjësisht në vlerë prej 428.14 euro.

Ankuesja me datë 09.12.2019 ka parashtruar kërkesën tek organi i punësimit respektivisht të Komuna e Prishtinës lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar si dhe pagave përcjellëse duke u bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, ndërsa në përgjigje të kërkesës së ankuesit Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me Vendimin numër 14-070/01-302359/19 të datës 20.12.2019 ka refuzuar ankesën e ankueses si të paafatshme, e të cilin vendim ankuesja e ka pranuar me datë 23.12.2019.

Ankuesja me datë 19.08.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin që bazuar në Kontratën Kolektive ti njihet kompensimi i tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit konstatoi së në kohën e pensionimit të ankueses përkatësisht nxjerrjes së Vendimit 14-118/02-116513/19 të datës 21.05.2019 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Vendimit me numër 14-070/01-302359/19 të datës 20.12.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës sipas të cilit me Nenin 81 është përcaktuar se: "1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2.

Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërlidhur me këtë, Neni 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës",

Andaj, duke ju referuar Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenit 127 më të cilin është përcaktuar se: " 1.Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;.. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashkuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj", Kolegji konstaton se ankesa e ankueses është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat ligjore si me lart, përkatësisht ankuesja Vendimin 14-070/01-302359/19 të datës 20.12.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka pranuar me datë 23.12.2019 moment ky nga i cili ka filluar të rrjedhë afati ligjor për animim në KPMSHCK, ndërsa ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshill më datë 19.08.2022 pra pas 2 vite e 7 muaj.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.715/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,